

**BASHKIA VAU DEJËS**  
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

1. Fillimi i procedurave përdhënie në përdorim me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 490 m2 pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk nr 3506, e llojit “Pa fryt”, me çertifikatëpronësie në favor të Bashkia Vau Dejës, ndodhur në fshatin Stajkë, Nj Ad Bushat, Bashkia Vau Dejës.

Procedurat do kryhensipas VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës, e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, si dhe Udhëzimit nr 13, datë26.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, (sipërshkruar).

2. Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit është 27 000 lekë/Ha nëvit, sipas pikës 34, të Udhëzimit nr 13, datë26.04.2018, “Për zbatimin e VKM-së nr 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës, e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Afati i dhënies në përdorim për pasurinë e llojit “Pa fryt”, është deri 10 vjet.

3. Qëllimi i përdorimit është dhënia në gëzim të përkohshëm esipërfaqes prej 490 m2, pjesë e pasurisë nr 546/4, Zk 3506, e llojit “Pa fryt”,për qëllime bujqësore, blegtorale, dhe agropërpunimi.

4. Pikët vlerësuese sipas kriterëve të konkurimit për subjektet pjesëmarrës do të jenë:

Nr .	Kriteret e konkurimit	Pikët vlerësuese për elementet e konkurimit
1	Niveli i investimit	30
2	Niveli i punësimit	30
3	Oferta e detyrimit mujor të qirasë	40

5. Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurentët pjesëmarrës është:

Personat fizik dhe juridik që marrin pjesë në konkurim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesën e subjektit bashkë me gjeneralitetet, për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku në të, të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit vjetor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurimit të parashikuar sipas planit të biznesit.

b) plani i biznesit e hollësishëm për vënien në funksion të pronës, në të cilin duhet të përshkruhet qartë; plani i punësimit, plani i investimeve, treguesit që do realizohen brenda njëperiudhe jo më të gjatë se ¼ e afatit të kontratës, të cilat duhet të ruhen deri në fund të afatit të kontratës, si dhe siglen dhe vulen e administratorit të shoqërisë, ose personit fizik, në çdo faqe të tij. c) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit, ku të përfshihet informacioni i mëposhtëm;

- Deklaratë mbi NIPT/NUIS të subjektit kërkues.
- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore.
- Deklaratë mbi administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

Nëratet kur subjekti konkurues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte pronë shtetërore, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

6.Vendi i zhvillimit të konkurimit:Adresa: Bashkia Vau Dejës, Zyra e Sektorit të Aseteve.

7.Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:Data 23.10.2023, ora 11.

8.Informacion mbi dokumentet e konkurimit:

Dokumentet e ankandit/konkurimit mund të tërhiqen pranë autoritetit qiradhënës.

Dokumente me pagesë:

Po X Jo

Nëse Po

Monedha lekë Çmimi 1500

Dokumentet standarde tëkonkurimit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

9).Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me poste ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e konkurimit.